



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0517

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahimimi duke vendosur sipas ankesës së (OE) “Eor Group” SH.P.K., kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit, të “Komuna e Vushtrrisë” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe instalimi i sistemit te mikrofonave me votim elektronik, zerim dhe përkthim simulant” me numër të prokurimit VU644-22-8348-1-2-1, me 03/09/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërishtë e bazuar ankesa e “Eor Group” SH.P.K. me nr.2024/0517, e datës 15/06/2024, kurse vendimi i AK “Komuna e Vushtrrisë” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe instalimi i sistemit te mikrofonave me votim elektronik, zerim dhe përkthim simulant” me numër të prokurimit VU644-22-8348-1-2-1.

2. Mbetet në fuqi, vendimi për anulim të aktivitetit të prokurimiti AK-së, i aktiviteti i prokurimit me titull: “Furnizimi dhe instalimi i sistemit te mikrofonave me votim elektronik, zerim dhe përkthim simulant” me nr. të prokurimit: VU644-22-8348-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “Komuna e Vushtrrisë”.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 17.08.2022, “Komuna e Vushtrrisë” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizimi dhe instalimi i sistemit të mikrofonave me votim elektronik, zerim dhe përkthim simulant” me nr. të prokurimit: VU644-22-8348-1-2-1. Ndërsa me datën 30.05.2024 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: - Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 55 000,00 €.

Me 02.06.2024, OE “Eor Group” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Për të cilën Autoriteti Kontraktues nuk i ka kthyer përgjigje në afat.

Me 15/06/2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Eor Group” SH.P.K., me nr. 2024/0517 për lidhur me aktivitetin “Furnizimi dhe instalimi i sistemit të mikrofonave me votim elektronik, zerim dhe përkthim simulant” me nr. të prokurimit: VU644-22-8348-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Eor Group” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Kërkojmë nga OSHP që të shqyrtojë ankesën tone dhe të kërkojë nga Autoritetin Kontraktues që të RI-SHQYRTOJË vendimin e datës 30.05.2024 duke e respektuar kërkesat e dhëna me FTD të dosjes së tenderit dhe duke u bazuar në dispozitat e LPP-së të dhe kërkesat e FTD-së të dosjes së tenderit të shpërblehet me kontratë OE EOR GROUP SHPK, pasi që në bazë të vendimit të datës 14.12.2022 jemi shpërblyer me njoftimin për dhënie të kontratës.

OE EOR GROUP SHPK është i përgjegjshëm dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e dhëna me DT. Të pakënaqur me mos përgjigjeje e AK-së rreth shqyrtimit të kërkesës tonë për rishqyrtim dhe në afat të rregullt kohorë, parashtrojmë ankesë pran OSHP-së. Mungonte përgjigjja e AK-së në kërkesën për rishqyrtim, pasi që AK-ja nuk është përgjigjur brenda afatit 5 ditorë të paraparë sipas LPP-së.

Ne kemi bërë Kërkesë për Rishqyrtim brenda afatit të rregullt kohorë, me datë 02.06.2024 dhe deri me datën 14.06.2024 Autoriteti Kontraktues nuk ka kthyer përgjigjeje. Bazuar në afatet kohore sipas LPP-së për kthimin e përgjigjejes, AK-ja ka tejkaluar afatet e parapara për përgjigjeje rreth shqyrtimit të kërkesës tonë për rishqyrtim. Në afat të rregullt kohorë, parashtrijmë ankesë pran OSHP-së. OE EOR GROUP SHPK kërkon nga PSH i OSHP-së të detyrojë Autoritetin Kontraktues të anulojë vendimin e datës 30.05.2024 dhe të kthejë vendimin e datës 14.12.2022 dhe të shpërblehet OE “EOR GROU”P SHPK me kontratë.

Ne konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar LPP-në pasi që nuk ka respektuar Nenet të LPP-së, si në vijim:

Neni 1- Qëllimi Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca Neni 62- Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit 1.

Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve. Bazuar në LPP dhe kërkesat e dosjes se tenderit OE EOR GROUP SH.P. K sipas njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues te dates:14.12.2022 është shpërblyer me kontratë.

OE EOR GROUP SHPK është i përgjegjshëm sipas FTD të dosjes se tenderit, pasi që ka vazhduar validitetin e ofertës pa shkelur dhe ka ofruar çmimin me të lirë të ofertës dhe brenda buxhetit, në këtë rast Autoriteti Kontraktues bazuar në Nenin 62 nuk mund të anuloi tenderin (përfundoi aktivitetin e prokurimit). Autoriteti Kontraktues me vendimin e 30.05.2024 ka shkelur dispozitat e LPP-së, gjegjësisht nenin 62 paragrafi 2.1 kur e ka anuluar tenderin!

Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të respektojë dispozitat e LPP-së, dhe bazuar në faktet se AK-ja ka buxhet për këtë tender pasi që me datën 28.05.2024 ka shpallë Njoftimin për kontratë “Zerim elektronik për sallën e Kuvendit” që është i njëjti tender për të njëjtën sallë të Kuvendit.

Bazuar në LPP, para shpalljes se Njoftimit për kontratë duhet të zotohen mjetet financiare pastaj të publikohet Njoftimi për Kontratë dhe deri sa të përfundoj procedura mjetet duhet të mbesin të siguruara dhe nuk mundë të shfrytëzohet për çëllime tjera.

Prandaj Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 30.05.2024 është në kundërshtim me LPP-në dhe kërkojmë që ky vendim të anulohet dhe të mbetet në fuqi vendim i datës: 14.12.2022 ku shpërblehet EOR GROUP SHPK.

Faktet e cekura për të vazhduar me nënshkrim të kontratës, janë:

I. Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat e LPP-së kur ka zvarritur mbi 550 ditë pas datës së vendimit 14.12.2022, ku AK-ja e shpall njoftimin mbi dhënien e kontratës dhe e shpërblen me kontratë EOR GROUP SHPK, pas periodës prej mbi 550 ditëve vonesë AK-ja merr vendim për anulim të tenderit. KONKLuzion: Mos respektimi i afateve kohore siç i parasheh LPP-ja është shkelje e rëndë.

II. Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 62 paragrafi 2 Bazuar në nenin 62 paragrafi 2, të LPP-së në këtë fazë Autoriteti Kontraktues nuk mundë të Përfundoj Aktivitetin e Prokurimit pasi që oferta e jonë është me e lira dhe përgjegjshme si dhe brenda buxhetit të paraparë nga AK-ja. KONKLuzion: Shkelja e nenit 62 të LPP-së është shkelje e rënd sipas LPP-së

III. Nuk pajtohemi me Autoritetin Kontraktues me arsyetimin e dhënë në Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues kur e anulon tenderin me arsyetimin se : “Drejtoresha e Drejtorisë për Administratë, në cilësinë e njësisë kërkuese, me shkrim ka njoftuar Drejtorinë për Prokurim se, citat : ‘ kërkojmë që aktiviteti i prokurimit .’ Furnizimi dhe instalimi i sistemit të mikrofrnave me votim elektronik, zërim dhe përkthim simultant “ të anulohet për shkak të mungesës së buxhetit në këtë vit.”

KONKLuzion: Ky fakt nuk qëndron pasi që me datën 28.05.2024, AK-ja ka shpallë Njoftimin për Kontratë për të njëjtin tender, që d.m.th AK-ja ka buxhetë për këtë tender. Mirëpo edhe nëse nuk ka buxhet AK-ja mundë të nënshkruaj kontratë me OE EOR GROUP SHPK dhe kur të siguroj buxhetin të vazhdohet me implementim të kontratës.

IV. OE EOR GROUP SH.P.K është i përgjegjshëm sipas FTD të dosjes së tenderit, pasi që ka vazhduar validitetin e ofertës pa shkëputje dhe ka ofruar çmimin me të lirë të ofertës dhe brenda buxhetit.

KONKLuzion: Bazuar në LPP në këtë rast Autoriteti Kontraktues, bazuar në Nenin 62 nuk mundë të anuloi tenderin (përfundoi aktivitetin e prokurimit). Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

KËRKOJMË: Nga Autoriteti Kontraktues të zbatoi vendimin e datës 14.12.2022 të veprojë konformë nenin 62 paragrafi 2, të anuloi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 30.05.2024 dhe të kthehet zbatimi i vendimit të datës 14.12.2022 që të nënshkruhet kontrata me OE "EOR GROUP" SHPK.

Shkelja e supozuar të LPP-së kanë qar deri ne marrjen e vendimit të gabuar Autoritetin Kontraktues për zvarritjen e zbatimit të vendimit të datës 14.12.2022 dhe mos nënshkrimin e kontratës për me shumë se 550 ditë me OE EOR GROUP SH.P.K dhe në këtë zvarritje ka shumë shkelje të dispozitave të LPP-së dhe po i mohohet e drejta ligjore EOR GROUP SHPK për shpërblimin me kontratë për kryerjen e furnizimeve në këtë projekt duke na dëmtuar padrejtësisht dhe duke na mohuar e drejta e jonë sipas LPP-së.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "Eor Group" SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 Neni 1- Qëllimi Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi dhe Transparenca Neni 62- Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit 1.te LPP-së. Kërkojmë nga PSH i OSHP që te detyroi Autoritetin Kontraktues të marr për bazë faktet e prezantuara dhe të anuloi vendimin e datës 30.05.2024 dhe të zbatohet vendimi i datës 14.12.2022 ku do të nënshkruhet kontrata me OE EOR GROUP SH.P.K pasi që jemi OE e përgjegjshëm dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e dhëna me dosjen e tenderit dhe njëherit kemi çmimin më te lirë, të shpërblyer me kontratë nga komisioni i vlerësimit te AK-së. Shkelja e supozuar ka ndodhur nga Autoriteti Kontraktues dhe ka shkelur pa dashje apo me dashje dispozitat e LPP-së (Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës). Bazuar në shkeljet e lartë cekura dhe faktet që posedojmë, ne do të vazhdojmë me procedurat ligjore, në të gjitha instancat që parashihen me ligj në Republikën e Kosovës. Shkeljet e dispozitave të cekura me lartë të LPP-së kanë ndodhur nga Autoriteti Kontraktues dhe Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat e LPP-së (Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës). Bazuar në shkeljet e lartë cekura dhe faktet që posedojmë, ne do të vazhdojmë me procedurat ligjore, në të gjitha instancat që parashihen me ligj në Republikën e Kosovës.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 25.06.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0517/2024, ndërsa me datë 02.07.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0517 me rekomandimet si në vijim: Duke pasur parasysh pretendimin ankimore dhe sqarimet e kërkuara nga ana e AK ne cilësinë e ekspertit shqyrtues konform Nenit 114 paragrafit 2 konstatoj dhe rekomandoj PSH.OSHP që ta aprovoj si te bazuar ankesën e operatorit ekonomik, te bëj anulimin e njoftimit mbi anulimin e aktiviteti dhe te kthehet procedura ne Rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk ka dhen përgjigje rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtuese, ndërsa OE pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Eor Group” SH.P.K., - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0517 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi ankimore i operatorit ekonomik është ndaj anulimit te aktivitetit te prokurimit.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Vushtrrisë, me datën 20.05.2024 ne baze te Njoftimit mbi vendimin e AK dhe Letrat Standarde ka bër anulimin e aktivitetit te prokurimit duku u bazuar ne Nenin 62 te LPP-së dhe Nenin 43 te RrPP Nr.001/2022 , ku ka theksuar:

Duke pasur parasysh se ky aktivitet figuron nga viti 2022, AK-Komuna e Vushtrrisë konform LPP-së Nenit 9, dhe Nenit 8 te RrPP-së Nr.001/2022, ka nënshkruar deklaratën mbi disponueshmerin e fondeve (DNPDP) me qërast ka dëshmuar se posedon mjetet e planifikuara për këtë aktivitet.

"Në pajtueshmëri me Nenin 9, paragrafi 5, të LPP-së Autoritetet Kontraktuese do të përdorë formularin standard B04 “Deklarata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmërisë së fondeve (DNPDP)” të përgatitur dhe miratuar nga KRPP për vlerësimin e nevojave dhe konstatimin e disponueshmërisë e fondeve. Aprovimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit do të konfirmohet me nënshkrim të DNPDP nga ZKA dhe ZKF"

Deklarata e disponueshmeris se fondeve (DNPDP) e aprovuar konform Nenit 9 te LPP dhe Nenit 8 te RrPP-së nga ana e AK-së Komuna e Vushtrrisë.

Por me qenëse nga viti 2022 deri tani vitin 2024 janë diferencë prej 2 viteve ne cilësinë e ekspertit shqyrtues konform LPP Nenit 114 paragrafit 1 me qëllim te vlerësimit dhe konstatimit te drejt dhe jo diskriminues dhe favorizues si dhe me qëllim te njoftimit sa më te saktë te panelin shqyrtues lidhur me pretendimet ankimore dhe bazën e anulimit te aktivitetit, ne baze te arsyetimit për anulim te aktivitetit me datën 27.06.2024 kam kërkuar një sqarim shitesë nga ana e AK me tekstin si ne vijim:

Ne cilësinë e ekspertit shqyrtues konform LPP po ju shkruaj këtë kërkesë për sqarim.: “Ne bazë te LPP siç kam par ne sistemin e prokurimit ne përfundim te këtij aktiviteti është nënshkruar deklarata e DNPDP qe dëshmon për mjetet financiare sipas planifikimet por me qen se e njëjta është e vitit 2022 dhe tani jemi ne vitin 2024, ju si AK ne njoftimin m mbi vendimin e AK keni theksuar se anulohet aktiviteti ne bazë te kërkesës te njëjesisë se kërkesës ne mungesë te mjeteve financiare andaj ju lutem qe te na përcjellin si dëshmi kërkesën e njëjesisë se kërkesës se bashku me dëshmitë tabelare te mungesës se buxhetit për këtë aktivitet te njëjtat te na i dërgoni ne e prokurim ose ne email.”

Në bazë te kësaj AK-Komuna e Vushtrrisë nuk ka arritur qe të kthej përgjigje dhe të dëshmoj se mungon mjetet financiare sipas arsyeje se anulimit dhe bazuar ne këtë ne cilësinë e ekspertit shqyrtues konstatoj se Anulimi i aktivitetit nga ana e AK është ne kundërshtim me Nenin 62 te LPP -së i cili thekson:

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet: 2.1. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit"

Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me tejkallim te buxhetit te planifikuar nga ana e AK, inicimi nga AK ka qenë 55,000.00 euro kurse oferta e operatorit ekonomik 43.430.00 euro, dhe është nën buxhetin e planifikuar si dhe mjetet financiare janë te konfirmuara ne DNPDP e aprovuar nga AK ku po ashtu edhe gjate sqarimeve nuk kanë dëshmuar se te njëjtat mjete mungojnë siç kanë potencuar ne anulim bazuar ne këtë si dhe bazuar se AK nuk ka arritur qe edhe pas kërkesës për sqarim te dëshmoj një gjë te tille konstatoj se pretendimi ankimore është i bazuar.

Sipas konstatimit te ekspertit shqyrtues në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur pjesërishtë besimin e raportit të ekspertit, për vet faktit se ne raportin e ekspertit shqyrtues thuhet se i është drejtuar AK-se duke kerkuar deshmi kerkesen e njesis kerkuese se bashku me deshmit tabelare te mungeses se bugjetit , si dhe ka kerkuar qe ti dergojne ne platformën e e-prokurimit ose ne e-mail, ndërsa ka deklaruar qe nuk ka pranuar informacion permes sistemit te e-prokurimit mirpo sipas shkresave të dokumentuara shifet që AK-ja në e-mail të ekspertit shqyrtues ka dorezuar tabelen bugjetore për vitin 2024.

- Gjetjet e Panelit -

Paneli shqyrtues konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka

nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar.

Paneli shqyrtues, fillimisht vlerësoi se kjo procedur ka filluar nga viti 2022, dy vite paraprake, ku kjo procedur evidentonet edhe në sistem të plaformës eletronike e-prokurimi.

Duke u bazuar në arsyetimin e ofruar nga AK-Komuna e Vushtrris, dhe për të vërtetuar saktësin sipas B58 Njoftim mbi vendimin e AK-së për këtë aktivitet të prokurimit per anulimin në tërsi të procedurës për shkak te mungeses se bugjetit, PSH- ja ka kerkuar nga AK-ja citoj ‘‘ dëshmi-prova lidhur me anulimin e procedures se prokurimit në tërsi , me arsyetim se kemi marur informacione nga njësia kërkuese në munges të mjeteve buxhetore . Përmes shkresave informuese kemi pranuar pergjigje nga AK-Komuna e Vushtrris ku ka ofruar Tabelen bugjetore për vitin 2024, si dhe shkresën informuese nga njesia kerkuese e datës 12.02.2024, ku në munges te bugjetit ka kerkuar që të anulohet ky aktivitet.

Paneli shqyrtues duke pas parasysh rrethanat e krijuara vlerëson se është e pamundur te vazhdohet me tutje me këtë aktivitet te prokurimit për faktin se AK-ja këtë procedur ka filluar ta inicioj në vitin 2022, dhe kur tani jemi në vitin 2024 , dhe sipas shkresave informuese nga AK-ja për pamundesin e implementimit të këtije projekti për shkak se këtë projekt nuk e ka të parashikuar në tabelën bugjetore për vitin ‘‘2024’’, dhe duke mos e future në obligime financiare sipas dispozitave të përcaktuara në Ligjin nr. 03/1-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligji nr. 08/1-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, Paneli aprovon vendimin e AK-se për anulim në tërsi të procedurës, mirpo për zvarritjen e kësaj procedure, dhe mos aplikimit të dispozivitit siç parashihet në nenin 108/A-te LPP-se i tërheq vërejtjen AK-së, në të kundërtën do të merren masa siç parashihen në LPP-në, për arsye se në këto raste dëmtohen operatorët ekonomik qe kanë shprehur interes për këtë aktivitet te prokurimit.

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marr në këtë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 6 si dhe nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese. Paneli Shqyrtues niset gjithnjë nga fakti se autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, dhe se janë përmbushur kushtet për aplikim të nenint 62 te LPP-e, nenin 43, paragrafi 43.5 (i) të RRPP-së, mirëpo mbetet në detyrimin e tyre ekspllicit respektimi i ligjshmërisë në procesin e prokurimit.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në baze të nenin 117 të LPP-së, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E VUSHTRISË, KOMUNA E VUSHTRISË**
- **OE - Eor Group SH.P.K., Eor Group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: